

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË



NOTER ERNITA A. HAXHIU  
ADRESA KAO KARAFILI,  
PALL."MC INERIE"  
TEL:

## KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 902

Nr. koleksioni: 759

Tirane më 17/07/2024

Ligjet referuese:

- Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Liqji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- Liqji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024050660080714065



Taksa e Pullës  
TIRANE

## KONTRATË DHURIMI KUOTE

Sot, më datë 17.04/2024, para meje Notere ERNITA A. HAXHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Kajo Karafili, Pall."Mc Inerte", u paraqit personalisht:

### PALA DHURUESE:

**Z.Laert Kasaj**, atësia Luan, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë Abdyl Frashëri; Nd. 17; H. 6; Ap. 24; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 06/03/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033676531 dhe nr. personal **I50306150V**,

(referuar në këtë kontratë si "Dhuruesi")

**Megi Gjoni (bashkëshortja)**, atësia Fatos, amësia Merita, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Abdyl Frashëri; Nd. 17; H. 6; Ap. 24; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 27/09/1992, gjendja civile "e martuar", madhere, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 033668202 dhe nr. personal **J25927049H**, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e pergjithshme" me Nr. Rep 315, Nr. kol 99, hartuar nga noter emira kapllani, në datë 07/02/2020, nga përfaqësues **Laert Kasaj**, atësia Luan, amësia Elida, shtetas shqiptar, lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë ABDYL FRASHËRI; Nd. 17; H. 6; Ap. 24; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, lindur më 06/03/1985, gjendja civile i martuar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal **I50306150**

(dhënëse pëlgimi)

### PALA PËRFITUESE:

**Z.Migen Kasaj**, atësia Luan, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në TIRANË, me adresë Artan Lenja; Nd. 38; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 07/05/1980, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037230481 dhe nr. personal **I00507210A**,

(referuar në këtë kontratë si "përfituesi i dhurimit")

(referuar në këtë kontratë si "Palët")

### MEQËNËSE EKZISTOJNË FAKTET:

**Z.Laert Kasaj**, është zotërues i 1(një) kuote që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë R&M Group sh.p.k., identifikuar me NUIS M01815004H;

**Znj.Megi Gjoni**, në cilësinë e bashkëshortes, është njohur me kushtet dhe parashikimet e kësaj kontrate si dhe me vendimin e shoqërisë R&M Group sh.p.k., nr.85, datë 17.04.2024 për dhurimin e kuotës te **Z.Migen Kasaj**, dhe pranon dhurimin e kuotës sipas termave të kësaj kontrate dhurimi.

**Z.Laert Kasaj**, në cilësinë e pronarit të kuotës që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë R&M Group sh.p.k., ka rënë dakord për dhurimin e kuotës së tij, të vëllait, **Z. Migen Kasaj**, identifikuar me nr. Personal I00507210A, sipas termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

**Z.Migen Kasaj**, identifikuar me leternjoftim me nr. 037230481, me nr. Personal I00507210A, pranon të bëhet pronar i kuotës së zotëruar nga **Z. Laert Kasaj**, kuotë e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë R&M Group sh.p.k., dhe që ka vlerë nominale 1,000,000.00 lekë(një milionë lekë).

Palët e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë, hartuan këtë kontratë dhurimi kuote, me përbajtjen si më poshtë:

Fq. 1



A2024050660080714065

## NENI 1 LIGJI I ZBATUESHËM

Hartimi dhe nënshkrimi i kësaj kontrate bazohet në nenet 705 e vijues të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Palët shprehin vullnetin që të përcaktojnë lirisht përbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legislacioni në fuqi dhe, në këtë rast, detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë marrin fuqinë e ligit për palët.

Kjo kontratë rregullohet dhe interpretohet nga ligji shqiptar. Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen shprehimisht nga kontrata, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjeve të tjera të zbatueshme.

## NENI 2 INTERPRETIMI I KONTRATËS

2.1 Kjo kontratë do të interpretohet duke mbajtur parasysh qëllimin e palëve siç është shprehur në këtë kontratë.

2.2 Secili nga kushtet e kësaj kontrate interpretohet në mënyrën që mundëson realizimin e objektit të saj.

2.3 Titujt e neneve të kësaj marrëveshjeje nuk ndikojnë në interpretimin e tyre.

2.4 Në këtë marrëveshje:

2.4.1 Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas, me përjashtim të rastit kur nga konteksti del plotësisht e qartë që zbatohet vetëm njëjësi ose shumësi, sipas rastit.

2.4.2 Afatet në ditë interpretohen si afate në ditë kalendarike. Dita, në të cilën ndodh ngjarja që shkakton fillimin e afatit, nuk llogaritet në afat.

2.5 Fjalët e përdorura në këtë marrëveshje kanë, sipas radhës, këtë kuptim:

2.5.1 Kuptimin e dhënë nga përkufizimet e kësaj marrëveshjeje.

2.5.2 Kuptimin e dhënë nga ligji dhe praktika gjyqësore.

Kuptimin e tyre të përgjithshëm si fjalë shqipe.

## NENI 3 QËLLIMI I KONTRATËS

Pala pranuese e dhurimit, z.Migen Kasaj., ka si qëllim që të bëhet pronar i kuotës së palës dhuruese, z.Laert Kasaj, kuotë e cila përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "R&M Group" sh.p.k., duke u bërë ortaku i vetëm i kësaj shoqërie.

Pala dhuruese e kuotës, z.Laert Kasaj, ka si qëllim të dhurojë kuotën e tij, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë R&M Group sh.p.k., te pranuesi i dhurimit z.Migen Kasaj.

Kjo kontratë ka si qëllim që palët të krijojnë një marrëveshje të plotë dhe të vetme që do të jetë në fuqi nga momenti i nënshkrimit dhe regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Kjo kontratë jep garanci dhe mbron palët në mënyrë të barabartë, duke i dhënë mundësi palëve të procedojnë me regjistrimin menjëherë pas nënshkrimit të saj, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## NENI 4 OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është: dhurimi i kuotës së zotëruar nga ortaku Z.Laert Kasaj, te pranuesi i dhurimit z.Migen Kasaj, si më poshtë:

Z.Laert Kasaj, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1,000,000.00 lekë (një milionë lekë), që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "R&M Group" sh.p.k., i dhuron kuotën e tij, palës pranuese të dhurimit, z.Migen Kasaj.

Z.Migen Kasaj, pranon të bëhet pronar i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1,000,000.00 lekë (një milionë lekë), që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "R&M Group" sh.p.k.

Pala dhuruese e kuotës, z.Laert Kasaj, nëpërmjet kësaj kontrate deklaron me vullnet të lirë dhe të plotë si dhe në bazë të legjisacionit në fuqi që dëshiron të kalojë nëpërmjet dhurimit, kuotën e tij te pala pranuese e dhurimit, z.Migen Kasaj, sic parashikohet në nenin 4.1 të kësaj kontrate.



A2024050660080714065

## NENI 5 PËRGJEGJËSITË DHE GARANCI TË PALËVE

5.1 Pala dhuruese e kuotës, nëpërmjet kësaj kontrate, garanton, si më poshtë: se është i vëmhi titullar i ligjshëm i kuotës që po transferon me këtë kontrate dhurimi; se këtë objekt dhurimi është plotësisht e lirë nga çdo barrë, detyrim, të drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjeter.

Së dhuruesi nuk ka detyrime financiare të pashlyera apo aq më tepër të padëkluarura ndaj institucioneve shtetërore apo personave të tretë fizik apo juridik; Kjo Kontratë nënshkruhet dhe dorëzohet rregullisht nga pala dhuruese dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për palën dhuruese dhe që duhet zbatuar prej tij, në përpunim me kushtet dhe asfatet e Kontratës; Mbi palën pranuese të dhurimit nuk rëndon asnje detyrim i lindur mbi kuotën që zotëron deri në momentin e kalimit të pronësisë të saj;

## NENI 6 PASOJAT E KËSAJ KONTRATE DHURIMI

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi, shoqëria "R&M Group" sh.p.k. me NUIS MO1815004H, do të ketë 1(një) ortak si më poshtë:

Z. Migen Kasaj, shtetas shqiptar, i biri i Luan-it, lindur më 07.05.1980 në Sarandë dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim me nr. 037230481, me nr. Personal I00507210A, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, pronar i një kuotë me vlerë nominale 1,000,000.00 lekë (një milionë lekë), që përfaqëson 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "R&M Group" sh.p.k.

Personi që kalon kuotën dhe ai që i fiton ato, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotës dhe deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas dispozitave në fuqi.

## NENI 7 INFORMACIONI KONFIDENCIAL

Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe cdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

## NENI 8 TRANSFERIMI I TE DREJTAVE

Menjëherë pas nënshkrimit të palëve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet pranë regjistrat tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala dhuruese e kuotës zhvishet nga çdo e drejtë që buron nga titulli i pronësisë mbi kuotën që po transferohet me anë të kësaj kontrate, të drejta dhe detyrime të cilat i kalojnë palës pranuese të dhurimit, sipas parashikimeve të kësaj kontrate.

## NENI 9 LIGJI I APLIKUESHËM DHE GJYKATA KOMPETENTE

Kontrata është hartuar në përpunim me Legjislacionin tregtar në fuqi.

Palët angazhohen të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konflikteve të mundshme që mund të krijojen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negocimeve të drejtëpërdrejtë.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, cështja do ti nënshtronhet juridiksonit gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë.

## NENI 10 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët.

Palët respektojnë konfidencialitetin e informacioneve që lidhen me palën tjeter.

Palët mund ta përdorin informacionin konfidencial të palës tjeter vetëm për qëllimet e kësaj kontrate dhe mund t'u japid këtë informacion palëve të treta, agjentëve, këshilltarëve profesionalë, shoqërive të lidhura, etj., vetëm në masën që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të kësaj kontrate.



A2024050660080714065

Përpunimi i të dhënave personale të mbledhura në zbatim të kësaj kontrate (sipas ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008) bëhet vetëm për qëllim të administrimit të marrëdhënieς që lind nga kjo kontratë. Të dhënat përpunoohen nga pala që i zotëron dhe nuk u shpërndahen të tretëve.

Secila palë ka në çdo kohë të drejtë t'i kërkojë palës tjeter ndryshimin ose fshirjen e të dhënave të tij apo të kundërshtojë përdorimin e tyre për dërgimin e informacioneve dhe materialeve tregtare që nuk lidhen me këtë kontratë. Kjo e drejtë ushtronhet nëpërmjet komunikimit me shkrim. Palët deklarojnë dhe konfirmojnë që kjo kontrate është lidhur me vullnetin e tyre të lirë dhe se ata janë në dijeni të pasojave ligjore që rrjedhin nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

Dokumentat që janë pjesë integrale e kësaj kontrate janë:

Ekstrakt i Regjistrat Tregtar për shoqërinë R&M Group sh.p.k.;

Vendim i asamblesë së ortakëve të shoqërisë "R&M Group" sh.p.k., nr.\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2024;

Dokumentet e identifikimit të palëve;

Prokurë e përgjithshme nr.315 rep., nr.99 kol., datë 07.02.2020;

Vërtetim nga Registri i Barrëve Siguruese;

Çertifikatë familjare e dhuruesit të kuotës.

Kjo kontrate eshte redaktuar ne 4 kopje dhe pasi u lexua nga palet, ato ishin dakort dhe u konsiderua e redaktuar sipas pëlgimit te tyre dhe u nenshkrua me vullnet te lire e te plote. Une noteri e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

#### PALËT KONTRAKTORE

**PALA DHURUESE**

**Z.LAERT KASAJ**

*Laert Kasaj*

**BASHKËSHORTJA:**

Megi Gjoni

*Përfaqësuar me prokurë nga Laert Kasaj*

*Laert Kasaj*

*Laert Kasaj*

**PALA PËRFITUESE**

**Z.MIGEN KASAJ**

*Migen Kasaj*

**NOTERE**  
**ERNITA HAXHIU**

*F. Haxhiu*

## REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit te kerkimit: D-20240717112415574  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 17.07.2024  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 11:24:15  
Lloji i Kerkimit: Emri i Personit Juridik  
Numri i Dokumentit: D-400-498-616

### LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

R&M GROUP SH.P.K.

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit



SUBJEKTI KERKUES:

Emertimi  
ERNITA ABDURAHMAN HAXHIU P.F.

Bajamelalala  
*B. Haxhiu*

TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri  
BAJAMELA LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEGA VENDORË E NOTERISË TIRANË  
NOTERE PUBLIKE ERMIRO B. KAPLLANI

Bul. "Gjergj Fishta". Kulla II, Kati I, Tiranë, +355 696042 358; [ermirakapllani@hotmail.com](mailto:ermirakapllani@hotmail.com)

Nr. 315 Rep.  
Nr. 99 Kol.

### PROKURË E PËRGJITHSHME

Në Tiranë, sot më 07/01/2020 (dymijë e njëzetë), para meje Noterit Publik Ermira B. Kapllani, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Blvd. "Gjergj Fishta", Kulla II, Kati I, Tiranë, u paraqit personalisht dhe me vullnetin e saj të lirë:

**Megi GJONI**, e bija e Fatos Gjoni dhe Merita Gjoni, e datëlindjes 27.09.1992, lindur dhe banuese në Tiranë, e identifikuar nga pasaporta biometrike me numër J25927049H, madhore, me zotesi të plotë për të vepruar (në vijim, "**e Përfaqësuara**").

MEQËNËSE e Përfaqësuara ka kërkuar dhe Përfaqësuesi ka pranuar të kryejë veprime juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit;

E PËRFAQËSUARA, me vullnetin e saj të lirë e të plotë, deklaron dhe nënshkruan sa parashikohet më poshtë në kushtet e kësaj prokure.

#### 1. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj prokure është caktimi i një përfaqësuesi për të Përfaqësuarën, i cili të veprojë për të realizuar interesat e saj në mungesën e saj, në përputhje me nenet 64 e vijues të Kodit Civil. Tagrat që i jepen Përfaqësuesit në këtë prokurë e bëjnë atë përfaqësues të përgjithshëm, në kuptim të nenit 71 të Kodit Civil.

#### 2. PËRFAQËSUESI I CAKTUAR

E Përfaqësuara cakton si mbrojtës të saj bashkëshortin **Laert Kasaj**, i biri i Luan Kasaj dhe i Elida Kasaj, lindur më 06.03.1985 në Skrapar dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga letërnjoftimi 033676531, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar (në vijim, "**përfaqësuesi**")

#### 3. LIGJI I ZBATUESHËM

3.1. Kjo prokurë është hartuar në përputhje me dispozitat e legjislativit shqiptar, në veçanti dispozitat e Kodit Civil, dhe rregullohet nga legjislativi shqiptar. Për interpretimin dhe zbatimin e kësaj prokure do të zbatohet legjislativi shqiptar.

3.2. Kjo është një prokurë e njëanshme, me anë të së cilës i Përfaqësuari ka shprehur vullnetin, duke përcaktuar lirisht përbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislativi në fuqi.

#### 4. PËRMBAJTJA E MARRËDHËNIES SË PËRFAQËSIMIT

4.1. Përfaqësuesi ka të drejtë të paraqitet para çdo institucioni të administrativës së pushtetit lokal (zyra të gjendjes civile, bashki, komuna etj.), të pushtetit qendor (çdo institucion shtetëror, ministri, drejtori, zyrë, etj. në nivel qendor), çdo entiteti publik apo çdo subjekti privat, qoftë ky individ, person fizik apo juridik, për të kryer pa kufizim çdo veprim e procedurë që lidhet me çdo lloj dokumenti të kërkuar apo të lëshuar në emrin e të Përfaqësuarës.

4.2. Përfaqësuesi ka të drejta të plota të bëjë veprime bankare në emrin e të Përfaqësuarës në çdo degë dhe arkë të çdo banke të nivelit të dytë, në të cilat mund të ketë llogari rrjedhëse, llogari kursimesh, depozita apo lloje te tjera llogarish, në emrin e saj personal ose të përbashkëta me persona të tjerë pa kufizim. Përfaqësuesit i jepet e drejta të paraqitet para çdo banke sikur të ishte vetë e Përfaqësuara, për të bërë tërheje

me para në dorë, transferata në llogari brenda apo jashtë vendit në çdo valutë që mund të rezultojë në këto llogari, të kryejë proceduren e mbylljes së çdonjërës prej këtyre llogarive, kurdo që ai ta shohë të nevojshme, si edhe çdo veprim tjetër bankar që Përfaqësuesi e konsideron në interesin e të Përfaqësuarës. Përfaqësuesi ka të drejtë të kryejë dhe të plotësojë të gjitha veprimet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar, nënshkruar dhe përfituar kredi të çdo lloji në emrin e të Përfaqësuarës ose në emrin e të dyve bashkarisht, duke nënshkruar aktet përkatëse para cilitdo që do t'i kërkohet, me të drejta të plota firme.

4.3. Përfaqësuesi ka të drejtë të administrojë çdo send të luajtshëm apo të paluajtshëm që rezulton i regjistruar në emër të të Përfaqësuarës, si pronare e vetme apo në bashkëpronësi, duke kryer çdo veprim juridik për dhënien me qira, në përdorim apo ushtrimin në ndonjë mënyrë tjetër të tagrave të pronarit mbi këtë send, sikur të ishte vetë e Përfaqësuara.

4.4. Përfaqësuesi ka të drejtë të administrojë çdo kuotë pjesëmarrjeje që rezulton në emër të të Përfaqësuarës në \*do shoqëri tregtare, si dhe \*do aktivitet të sajin si person tregtar, duke ushtruar të drejtën e votës, sikur të ishte vetë e Përfaqësuara.

4.5. Përfaqësuesi ka të drejtë të kryejë çdo veprim juridik për transferimin tek persona të tjera, me çdo mënyrë të njojur nga ligji si të ligjshme, të pronësisë mbi sendet e luajtshme apo të paluajtshme, si edhe të letrave me vlerë, instrumentave financiare dhe çdo kuote pjesëmarrjeje në \*do shoqëri tregtare, që janë të regjistruara në emrin e të Përfaqësuarës apo mund të regjistrohen në emrin e saj gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj prokure. Për këtë qëllim, Përfaqësuesi ka të drejtë të negociojë me palen që pranon të fitojë titullin e pronësisë dhe të paraqitet para çdo zyre noterie, institucioni shtetëror, publik apo privat për të kryer veprimet e procedurat që janë të nevojshme për transferimin e titullit të pronësisë. Ai ka të drejtë të paraqitet para Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, çdo Zyre Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të kërkoi, të depozitojë, të tërheqë, të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm të pronësisë e të ndjekë procedurat përkatëse pa kufizim. Në rast të nënshkrimit të kontratave të shitjes për pasuritë si më lart, ka të drejta të plota të kryejë çdo pagesë të detyrueshme për këtë qëllim, duke vepruar në cilësinë e palës shitëse, si edhe të pranojë dhe të lejojë kalimin e çmimit të shitjes në llogaritë bankare të të Përfaqësuarës, në çdo bankë të nivelit të dytë, në çdo lloj valute dhe duke ruajtur të drejtën t'i depozitojë, tërheqë, transferojë të gjitha çmimet e shitjeve në cilëndo llogari bankare, në çdo bankë brenda ose jashtë Shqipërisë.

4.5. Përfaqësuesi ka të drejtë që, nëse ndesh vështirësi, refuzime apo pengesa burokratike në ushtrimin e detyrave të mësipërmë apo realizimin e interesave të të Përfaqësuarës, të ndjekë rrugën e ankimit administrativ në të gjitha shkallët për çdo akt apo veprim administrativ që sjell pasoja ligjore për të drejtat dhe interesat e të Përfaqësuarës.

4.6. Në ushtrim të detyrave të mësipërmë për realizmin e të drejtave dhe interesave të të Përfaqësuarës, Përfaqësuesi ka të drejtë që të hartojë çdo akt dhe të kryejë çdo veprim material dhe procedural që vetë e Përfaqësuara mund të kryente përpala të gjitha gjykatave të Republikës së Shqipërisë dhe ta përfaqësojë atë si paditëse në çdo gjykim civil, për çfarëdo lloj objekti. Gjithashtu, Përfaqësuesi ka të drejtë ta përfaqësojë të përfaqësuarën në çdo gjykim civil, në të cilin ajo mund të thirret si palë e paditur apo person i tretë apo i interesuar, për çfarëdolloj objekti. Përfaqësuesi e kryen përfaqësimin në gjykatë, në çfarëdo cilësie, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore për realizimin e mbrojtjes që i njihen vetë të Përfaqësuarës. Ai ka të drejtë të paraqesë kërkesa, kërkëspadi, kundërpadi, ankime dhe rekurse, si edhe t'i nënshkruajë vetë ato, të përcaktojë lirisht objektin e padisë dhe të kërkësave procedurale dhe t'i ndryshojë apo shtojë ato sipas vlerësimit të tij. Ai ka të drejtë të caktojë lirisht cilësinë dhe pozitën procedurale të të Përfaqësuarës në proceset gjyqësore që do të zhvillohen, duke përdorur të gjitha mjetet e mbrojtjes, duke fituar edhe të drejtën të emërojë avokatë, ta zgjidhë çështjen me pajtim, duke pasur tagrin të hartojë e të nënshkruajë vetë marrëveshjen. Përfaqësuesi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për vënien në ekzekutim të vendimeve të dhëna, si edhe ta përfaqësojë të Përfaqësuarën përpala organeve përmbarimore, shtetërore ose private.

4.7. Përfaqësuesi ka të drejtë të bëjë kallëzim penal dhe te përfaqësojë të Përfaqësuarën në cilësinë e kallëzueses apo viktims së veprës penale për çdo veprim apo mosvperim me natyrë penale që sjell pasoja ligjore për të drejtat dhe interesat e të Përfaqësuarës. Ky përfaqësim mund të bëhet në të gjitha shkallët e procesit penal dhe në të gjitha nivelet e gjykimit, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore që i njohen vetë të Përfaqësuarës.

4.8. Perfaqesuesi ka të gjitha të drejta apo kompetencat e tjera që, edhe pse nuk janë përfshirë në mënyrë të shprehur në këtë prokurë, janë të nevojshme për të realizuar sa më sipër, duke mos e konsideruar këtë si të metë të prokurës, por duke e interpretuar atë nën dritën e natyrës së përgjithshme të prokurës.

4.9. Në rast se e sheh të nevojshme për të realizuar përfaqësimin në mënyrën e duhur, Përfaqësuesi ka të drejta të plotë për të caktuar avokat, zyre avokatie, studio ligjore apo përfaqësues ligjor.

4.10. Cdo veprim i kryer nga Përfaqësuesi në ushtrim të të drejtave të dhëna më sipër konsiderohen nga të gjithë si të rregullta dhe të ligjshme dhe pranohen me të gjitha efektet sikur të ishin kryer nga e Përfaqësuara.

#### 5. DISPOZITA TË TJERA

- 5.1. Përfaqësuesi i ushtron të drejtat e mësipërme në mungesë të të Përfaqësuarës.
- 5.2. Veprimet e kryera nga Përfaqësuesi në zbatim të kësaj prokure konsiderohen si të kryera nga e Përfaqësuara.
- 5.3. Kjo prokurë është e vlefshme për një periudhe të pacaktuar. I Përfaqësuari ruan të drejtën për ta revokuar atë në çdo kohë.
- 5.4. Vlefshmëria e prokurës mbaron në kushtet e nenit 76 të Kodit Civil.

Prokura u redaktua sipas kërkesës dhe vullnetit të lirë dhe të plotë të të Përfaqësuarës, në katër kopje origjinale, me përbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, dhe iu lexua me zë të lartë dhe të kuptueshëm të Përfaqësuarës, e cila e lexoi edhe vetë dhe u shpreh se e ka kuptuar, e pranojë dhe e nënshkruan në prezencën time, pa vërejtje, me emër e mbiemër, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 102 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Unë, noterja, pasi u binda për vullnetin e deklarimit, lejoj nënshkrimin dhe vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimit, në bazë të ligjit Nr.110/2018, date 20.12.2018 “Për Noterinë”.


#### 3 PËRFAQËSUARA

MEGI GJONI



NOTERE PUBLIKE

ERMIRA B. KAPLLANI



**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË TREGTARE**

**R&M GROUP SH.P.K.**

(Nr. 85, datë 17.07.2024)

Në Tiranë, sot, më datë 17.07.2024, u mblohd Asambleja e Ortakut të vetëm të shoqërisë “R&M GROUP” sh.p.k., identifikuar me NUIS M01815004H, me adresë në Rrugën e Kavajës, pallatet e shoqërisë “Park Construction Albania”, Godina D, Hyrja A, Tiranë, Shqipëri.

Të pranishëm në mbledhje ishin:

- Laert Kasaj**, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 06.03.1985 në Skrapar, banues në Tiranë, Shqipëri, i pajisur me Letërnjoftim me nr.personal I50306150V, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë R&M Group sh.p.k.,

për të diskutuar dhe vodosur në lidhje me rendin e ditës si më poshtë:

- Propozimin për dhurimin e kuotës së zotëruar nga ortaku Laert Kasaj, kuotë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë R&M Group sh.p.k., te pranuesi i dhurimit z.Migen Kasaj, identifikuar me letërnjoftim me nr. 037230481, me nr. Personal I00507210A.
- Ngarkohet administratori i shoqërisë R&M Group sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose të autorizojë persona të tretë për kryerjen e regjistrimit pranë QKB-së.
- Të tjera.

Në përfundim, ortaku i vetëm i shoqërisë, pasi u njoh me rendin e ditës dhe pasi shqyrtoi materialin e paraqitur, në zbatim të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Statutit,

**V E N D O S I :**

- Miratimin e dhurimit të kuotës së zotëruar nga ortaku Laert Kasaj, kuotë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë R&M Group sh.p.k., te pranuesi i dhurimit z.Migen Kasaj, identifikuar me letërnjoftim me nr.037230481, me nr. Personal I00507210A.
- Ngarkohet administratori i shoqërisë R&M Group sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose të autorizojë persona të tretë për kryerjen e regjistrimit pranë QKB-së.
- Të tjera.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË “R&M GROUP” SH.P.K.**

**ORTAKU I VETËM**

**LAERT KASAJ**

*J. Kasaj*  
(emrë, mbiemrë, firmë, rreth)

